



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 167

Tiranë – E mërkurë, 20 shtator 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 85/2017, datë 14.9.2017	Për zgjedhjen e byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit.....	7579
Vendim i Kuvendit nr. 86/2017, datë 14.9.2017	Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit.....	7580
Vendim i Kuvendit nr. 88/2017, datë 14.9.2017	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	7581
Vendim i Kuvendit nr. 89/2017, datë 14.9.2017	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”.....	7581
Vendim i Kuvendit nr. 90/2017, datë 14.9.2017	Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit...	7582
Dekret i Presidentit nr. 10620, datë 19.9.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7585
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 899, datë 14.9.2017	Për anulimin e udhëzimit nr. 308, datë 22.5.2017, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të SHPSF-së”.....	7585
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 564, datë 18.9.2017	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, për funksionarin publik z. Frederik Vorfi, anëtar i Këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.....	7585
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 33, datë 6.9.2017	Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Maliq.....	7588

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 34, datë 6.9.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 4, datë 3.2.2017, “Për licencim sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Elbasan”.....	7588
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 35, datë 6.9.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 51, datë 2.12.2016, “Për rinovimin e licencës të sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe”.....	7588
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 36, datë 6.9.2017	Për licencimin për herë të parë të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Cërrrik.....	7589
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 37, datë 6.9.2017	Për miratimin e udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave.....	7589
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Spiro Zoga.....	7593
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të vdekur të shtetases Erinda Vladi.....	7593



VENDIM
Nr. 85/2017

PËR ZGJEDHJEN E BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8, 9, 10 dhe 10/1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen në detyrën e zëvendëskryetarëve të Kuvendit deputetët:

1. Vasilika Hysi PS
2. Edi Paloka PD

II. Zgjidhen në detyrën e sekretarëve të sekretariateve:

1. Anastas Angjeli - Sekretar për Buxhetin PS
2. Florion Mima - Sekretar për Buxhetin PD
3. Alket Hyseni - Sekretar për Procedurat dhe Votimet PS
4. Viktor Tushaj - Sekretar për Statusin e Deputetit LSI
5. Besnik Baraj - Sekretar për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën e Botimet Parlamentare PS
6. Ervin Bushati - Sekretar për Marrëdhëniet me Jashtë PS

III. Zgjidhen sekretariatet e Kuvendit si më poshtë:

Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit

1. Evis Kushi anëtare PS
2. Blerina Gjylameti anëtare PS
3. Gledion Rehovica anëtar LSI

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet

1. Adnor Shameti anëtar PS
2. Enkelejd Alibeaj anëtar PD

Sekretariati për Statusin e Deputetit

1. Xhemal Qefalia anëtar PS
2. Ilir Pendavinji anëtar PS

Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare

1. Musa Ulqini anëtar PS
2. Romeo Gurakuqi anëtar PD

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë

1. Elona Hoxha anëtare PS
2. Aldo Bumçi anëtar PD

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.9.2017



VENDIM
Nr. 86/2017

PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit është si më poshtë:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- | | | |
|--------------------|-----------------|----|
| 1. Ulsi Manja | kryetar | PS |
| 2. Eduard Halimi | zëvendëskryetar | PD |
| 3. Klotilda Bushka | sekretare | PS |

Komisioni për Integrimin Europian

- | | | |
|-----------------|-----------------|----|
| 1. Genc Pollo | kryetar | PD |
| 2. Bledar Çuçi | zëvendëskryetar | PS |
| 3. Fatmir Velaj | sekretar | PS |

Komisioni për Politikën e Jashtme

- | | | |
|------------------|------------------|-----|
| 1. Mimi Kodheli | kryetare | PS |
| 2. Klajda Gjoshë | zëvendëskryetare | LSI |
| 3. Elona Hoxha | sekretare | PS |

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

- | | | |
|--------------------|------------------|----|
| 1. Erion Braçe | kryetar | PS |
| 2. Jorida Tabaku | zëvendëskryetare | PD |
| 3. Anastas Angjeli | sekretar | PS |

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

- | | | |
|-----------------------------|-----------------|----|
| 1. Ermonela Valikaj (Felaj) | kryetare | PS |
| 2. Flamur Noka | zëvendëskryetar | PD |
| 3. Pjerin Ndreu | sekretar | PS |

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

- | | | |
|------------------|-----------------|----|
| 1. Eduard Shalsi | kryetar | PS |
| 2. Florion Mima | zëvendëskryetar | PD |
| 3. Besnik Baraj | sekretar | PS |

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

- | | | |
|--------------------|------------------|-----|
| 1. Petrit Vasili | kryetar | LSI |
| 2. Elisa Spiropali | zëvendëskryetare | PS |
| 3. Klodiana Spahiu | sekretare | PS |

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

- | | | |
|------------------|------------------|----|
| 1. Albana Vokshi | kryetare | PD |
| 2. Milva Ekonomi | zëvendëskryetare | PS |
| 3. Fidel Ylli | sekretar | PS |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 14.9.2017



VENDIM
Nr. 88/2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 20, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Si rregull, deputeti mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni të përhershëm. Në respektim të raporteve shumicë parlamentare - opozitë, deputetë të caktuar mund të jenë anëtarë të jo më shumë se dy komisioneve të përhershme. Deputeti mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve të tjera, por pa të drejtë vote.”.

2. Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

1. Kryesia e komisionit të përhershëm përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët dhe sekretari, ndërsa ajo e nënkomisionit nga kryetari dhe zëvendëskryetarët.

2. Në rast se kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari që i përket shumicës parlamentare. Në mungesë të këtij të fundit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari që i përket grupit më të madh të pakicës parlamentare.

3. Përcaktimi i përbërjes së kryesive të komisioneve të përhershme dhe të nënkomisioneve bëhet duke mbajtur parasysh përfaqësimin në to të grupeve parlamentare, sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend.”.

3. Në nenet 23, pika 2, 29, pika 2, 33, pika 1, dhe 36, pika 2, fjala “zëvendëskryetari/n” bëhet “zëvendëskryetarët”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.9.2017

VENDIM
Nr. 89/2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2017 “PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhet kjo shtesë:



- I. Deputeti Tritan Shehu (PD) caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Politikën e Jashtme.
 II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 14.9.2017

VENDIM
Nr. 90/2017

PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit është si më poshtë:
 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

1. Vasilika Hysi	anëtare	PS
2. Adnor Shameti	anëtar	PS
3. Bashkim Fino	anëtar	PS
4. Bledar Çuçi	anëtar	PS
5. Edmond Leka	anëtar	PS
6. Alket Hyseni	anëtar	PS
7. Saimir Tahiri	anëtar	PS
8. Jurgis Çyrbja	anëtar	PS
9. Oerd Bylykbashi	anëtar	PD
10. Enkelejd Alibeaj	anëtar	PD
11. Gent Strazimiri	anëtar	PD
12. Dhurata Çupi	anëtare	PD
13. Fatmir Mediu	anëtar	PR
14. Nasip Naço	anëtar	LSI
15. Edmond Panariti	anëtar	LSI
16. Tom Doshi	anëtar	i pavarur

Komisioni për Integrimin Europian

1. Elisa Spiropali	anëtare	PS
2. Sadri Abazi	anëtar	PS
3. Musa Ulqini	anëtar	PS
4. Ilir Pendavinji	anëtar	PS
5. Taulant Balla	anëtar	PS
6. Arben Kamami	anëtar	PS
7. Klodiana Spahiu	anëtare	PS
8. Aldo Bumçi	anëtar	PD
9. Vangjel Dule	anëtar	i pavarur
10. Grida Shqima	anëtare	PD
11. Jorida Tabaku	anëtare	PD
12. Monika Kryemadhi	anëtare	LSI
13. Viktor Tushaj	anëtar	LSI

Komisioni për Politikën e Jashtme



1. Andrea Marto	anëtar	PS
2. Ervin Bushati	anëtar	PS
3. Adnor Shameti	anëtar	PS
4. Evis Kushi	anëtare	PS
5. Klotilda Bushka	anëtare	PS
6. Eglantina Gjermani	anëtare	PS
7. Vasilika Hysi	anëtare	PS
8. Rudina Hajdari	anëtare	PD
9. Edi Paloka	anëtar	PD
10. Klevis Balliu	anëtar	PD
11. Nard Ndoka	anëtar	i pavarur
12. Gledion Rehovica	anëtar	LSI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat		
1. Ervin Bushati	anëtar	PS
2. Blerina Gjylameti	anëtare	PS
3. Evis Kushi	anëtare	PS
4. Xhevit Bushaj	anëtar	PS
5. Antoneta Dhima	anëtare	PS
6. Ilir Xhakolli	anëtar	PS
7. Arben Pëllumbi	anëtar	PS
8. Roland Xhelili	anëtar	PS
9. Edmond Spaho	anëtar	PD
10. Agron Shehaj	anëtar	PD
11. Dashamir Shehi	anëtar	i pavarur
12. Nadire Meçorapaj	anëtare	PR
13. Fatbardha Kadiu	anëtare	PR
14. Përparim Spahiu	anëtar	LSI
15. Edmond Haxhinasto	anëtar	LSI
16. Reme Lala	anëtare e pavarur	
Komisioni për Sigurinë Kombëtare		
1. Xhemal Qefalia	anëtar	PS
2. Paulin Sterkaj	anëtar	PS
3. Anduel Xhindi	anëtar	PS
4. Vullnet Sinaj	anëtar	PS
5. Luan Duzha	anëtar	PS
6. Elona Hoxha	anëtare	PS
7. Sadi Vorpsi	anëtar	PS
8. Luan Harusha	anëtar	PS
9. Xhemal Gjünkshi	anëtar	PD
10. Ervin Saliانji	anëtar	PD
11. Anton Frrokaj	anëtar	PD
12. Myslym Murrizi	anëtar	PD
13. Isuf Çelaj	anëtar	PR
14. Luan Rama	anëtar	LSI
15. Endrit Braimllari	anëtar	LSI
16. Aqif Rakipi	anëtar	i pavarur
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin		
1. Ilir Beqaj	anëtar	PS
2. Gjetan Gjetani	anëtar	PS
3. Rrahman Rraja	anëtar	PS



4. Eglantina Gjermeni	anëtare	PS
5. Andrea Marto	anëtar	PS
6. Rakip Suli	anëtar	PS
7. Tatiana Nurçe	anëtare	PS
8. Ilir Ndraxhi	anëtar	PS
9. Endri Hasa	anëtar	PD
10. Lorenc Luka	anëtar	PD
11. Izmira Ulqinaku	anëtare	PD
12. Hekuran Hoxhalli	anëtar	PR
13. Robert Bitri	anëtar	LSI
14. Agron Çela	anëtar	LSI
15. Lefter Koka	anëtar	LSI
16. Bujar Muça	anëtar	i pavarur

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

1. Flamur Golemi	anëtar	PS
2. Ilir Pendavinji	anëtar	PS
3. Edlira Bode	anëtare	PS
4. Adelina Rista	anëtare	PS
5. Arben Kamami	anëtar	PS
6. Roland Xhelilaj	anëtar	PS
7. Elona Hoxha	anëtare	PS
8. Nuri Belba	anëtar	PS
9. Bardh Spahia	anëtar	PD
10. Halim Kosova	anëtar	PD
11. Grida Shqima	anëtare	PD
12. Orjola Pampuri	anëtare	PD
13. Lindita Metaliaj	anëtare	PD
14. Vangjel Tavo	anëtar	LSI
15. Floida Kërpaçi	anëtare	LSI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

1. Musa Ulqini	anëtar	PS
2. Vilma Bello	anëtare	PS
3. Fatmir Velaj	anëtar	PS
4. Ismet Beqiraj	anëtar	PS
5. Fadil Nasufi	anëtar	PS
6. Adelina Rista	anëtare	PS
7. Bujar Çela	anëtar	PS
8. Almira Xhambulla	anëtare	PS
9. Luçiano Boçi	anëtar	PD
10. Luan Baci	anëtar	PD
11. Romeo Gurakuqi	anëtar	PD
12. Valentina Duka	anëtare	PD
13. Kejdi Mehmetaj	anëtare	LSI
14. Shezai Rrokaj	anëtar	LSI
15. Nora Malaj	anëtare	LSI

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miruar në datën 14.9.2017

**DEKRET****Nr. 10620, datë 19.9.2017****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, dhe nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Kulturës,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Erzen Salih Shkololli
2. Visar Salaedin Vishka
3. Venera Menderes Lumani
4. Lind Bedri Islami

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM**Nr. 899, datë 14.9.2017**

**PËR ANULIMIN E UDHËZIMIT NR. 308,
DATË 22.5.2017, TË MINISTRIT TË
PUNËVE TË BRENDSHME, “PËR
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PRIVAT
TË SIGURISË FIZIKE DHE QENDRËS
SË TRAJNIMIT PRIVAT TË
PUNONJËSVE TË SHPSF-së”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të neneve 113 dhe 114, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ministri i Brendshëm

VENDOSI:

1. Anulimin e udhëzimit nr. 308, datë 22.5.2017, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, personeli i subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrat e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafa**

VENDIM**Nr. 564, datë 18.9.2017**

**PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË
VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME, PËR FUNKSIONARIN
PUBLIK Z. FREDERIK VORFI, ANËTAR I
KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË, NË
ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË
PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 18.9.2017, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar
Hysen Osmanaj	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen, me:

Objekt: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik, z. Frederik Fran Vorfi, anëtar i Këshillit të Bashkisë Mirditë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Bazë ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”; neni 15, pika 3, i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, pika 12, 13, 14, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të



parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte, si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Frederik Fran Vorfi, rezulton se është ndaluar, hetuar dhe gjykuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga autoritetet zvicerane, Bern me dëbim nga shteti zviceran, për 5 vjet, për veprën “Emigracion i paligjshëm”, në vitin 1996.

Pas verifikimit të formularit, në përputhje me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 dhe kreu VI, pika 6; kreu V, pika 3, germa “b” të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, KQZ-ja me shkresën nr. 562, datë 3.2.2017, vendosi t’ia kalojë rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga “Sektori i verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me shkresën nr. 393/1 prot., datë 17.2.2017, i është kërkuar informacion për gjendjen gjyqësore Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kurse me shkresën nr. 1083/10 ex- 16, datë 17.2.2017, i është kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Nga përgjigjet e ardhura dhe verifikimet e kryera, rezulton se subjekti z. Frederik Vorfi, nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë nga autoritetet gjyqësore shqiptare, këto të dhëna janë pasqyruar dhe në dëshminë e gjendjes gjyqësore nr. 11, datë 22.2.2017, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, referuar së cilës, subjekti rezulton “I padënuar”. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1418/1, datë

27.2.2017, ka vënë në dispozicion të dhënat personale të subjektit, nga të cilat rezulton se z. Frederik Vorfi ka të njëjtat gjeneralitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit.

Me shkresën nr. 393/3, datë 6.9.2017, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, i ka dërguar në KQZ, vendimin e rezultatit të verifikimit për z. Frederik Vorfi, me detyrë anëtar i Këshillit të Bashkisë, Mirditë.

KQZ-ja, referuar nenit 15 të ligjit nr. 138/2015, vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është institucioni kompetent për shqyrtimin e rezultateve të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për z. Frederik Vorfi.

Pas rezultatit të verifikimit për z. Frederik Vorfi, me detyrë anëtar i Këshillit të Bashkisë, Mirditë, referuar pikës 12 dhe 13, kreu V i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja vlerëson se për sa u përket procedurave të ndjekura për rezultatet e verifikimit, në lidhje me të dhënat në formularin e deklarimit, referuar pikës 1 dhe 2, të nenit 8, të ligjit nr. 138/2015 dhe pikës 5, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në këtë fazë të procesit, KQZ-ja duhet të kryejë procedurat e mëposhtme:

I. Të shqyrtojë nëse janë evidentuar nga procesi i verifikimit të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Neni 2, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon: “Nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar bashkie apo këshilltar në këshillin bashkiak dhe, në çdo rast, nuk mund të marrin një funksion me votim nga Kuvendi, përfshirë funksionin e Kryeministrit apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave apo me votim nga këshillat bashkiakë ose të qarkut, personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për: a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas



neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88, paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278, paragrafi i parë, i pestë e i gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287, i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a, të Kodit Penal;

b) ...”

Nga shqyrtimi i procesit të verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se:

z. Frederik Vorfi është dënuar për veprë penale “Shkelje të ligjit mbi narkotikët”, parashikuar në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kreu VIII, seksioni III, konkretisht, neni 283, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar të nenit 2, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 138/2015. Sipas parashikimit ligjor të këtij neni përfshihen në këtë pikë personat e dënuar me vendim të formës së prerë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprave penale të përfshira në kreun VIII, seksionin III, përkatësisht, neni 283 të Kodit Penal, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Z. Frederik Vorfi është dënuar me vendimin nr. 98/0153 akti, datë 12.2.1998 nga Gjykata Rajonale Bern-Lupen:

1. Shkelje të ligjit mbi narkotikët në bashkëpunim me marrjen, posedimin e 48.3 gramë heroinë dhe shitjen e 18.8 gramë heroinë;

2. Shkelje e ligjit të trafikut, duke përdorur pa autorizim një biçikletë;

3. Shkelje e ligjit mbi transportin, duke udhëtuar në mënyrë të përsëritur me tren pa biçikletë të vlefshme, është dënuar me 9 muaj burg, me kusht për 2 vjet dhe ndalim hyrjeje në territorin zviceran, për 5 vjet. Vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikohet nga neni 2, pika 1, germa “a”, e ligjit nr. 138/2015.

Vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” e parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar, në nenin 283, përfshihet, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa “a”, e ligjit nr. 138/2015.

II. Sipas pikës 13, kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga nenin 2, të ligjit nr. 138/2015, KQZ-ja verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 138/2015.

Neni 4, i ligjit nr. 138/2015

1. Për personat që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.

2. ...

3. ...

Referuar nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 138/2015, periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit për personat e dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 2, pika 1, germa “a”, e këtij ligji, zgjat gjatë gjithë jetës. Z. Frederik Vorfi është dënuar me vendim të formës prerë nga Gjykata Rajonale Bern-Lupen, për veprën penale, “Shkelje të ligjit mbi narkotikët”, të parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar, në nenin 283. “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e përfshirë në nenin 2, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 138/2015. Në këto kushte z. Frederik Vorfi është brenda periudhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Z. Frederik Vorfi, në lidhje me të dhënat për dënim për kryerjen e veprës penale, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit, sipas parashikimeve të nenit 2, pika 1, germa “a”, neni 4, pika 1, të ligjit 138/2015.

Vepra penale e kryer dhe dënimi i caktuar ndaj z. Frederik Vorfi, përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi është dënuar me 9 (nëntë) muaj burg, për shkelje të ligjit mbi narkotikët, në bashkëpunim me marrjen, posedimin e 48.3 gramë heroinë dhe shitjen e 18.8 gramë heroinë”, që, si veprë penale është e parashikuar në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kreu VIII, seksioni III, konkretisht, neni 283, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. Vepra penale parashikohet si ndalim në pikën 1/a, të ligjit nr. 138/2015.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa “d”; nenin 14; nenin 15, pika 3, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreun V, pika 12, 13, 14 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Mirditë, z. Frederik Vorfi.
2. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM

Nr. 33, datë 6.9.2017

**PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME MALIQ**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Maliq, me:
Drejtues ligjor: Petrit Kupe
Drejtues teknik: Spase Male

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Maliq autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar, në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Maliq.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 34, datë 6.9.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 4, DATË 3.2.2017, “PËR LICENCIM
SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 4, datë 3.2.2017, “Për licencim sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Elbasan”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Besmir Prifti

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 35, datë 6.9.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 51, DATË 2.12.2016, “PËR RINOVIMIN
E LICENCËS TË SHA UJËSJELLËS
MALËSI E MADHE”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe



largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 51, datë 2.12.2016, “Për rinovimin e licencës të sh.a. Ujësjellës Malësi e Madhe” bëhen këto ndryshime:

1. Drejtues ligjor: Ndoc Prela
 2. Drejtues teknik: Adi Hasanaj
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndrëçim Shani

VENDIM
Nr. 36, datë 6.9.2017

**PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË
TË SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME
CËRRIK**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik, me:
Drejtues ligjor: Ervis Calja
Drejtues teknik: Jona Belshi
2. Operatori sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Cërrik autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Cërrik.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

KRYETARI
Ndrëçim Shani

VENDIM
Nr. 37, datë 6.9.2017

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR
ORGANIZIMIN E SEANCËS DËGJIMORE
ME PUBLIKUN NË PROCESIN E
MIRATIMIT TË TARIFAVE**

Në zbatim të nenit 14, germa “e” dhe “i”, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të miratojë “Udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun në procesin e miratimit të tarifave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë e pandarë e tij.
 2. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
 3. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 26, datë 8.7.2015, “Për miratimin e udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore me publikun, në procesin e miratimit të tarifave”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndrëçim Shani

**UDHËZUES PËR ORGANIZIMIN E
SEANCËS DËGJIMORE ME PUBLIKUN NË
PROCESIN E MIRATIMIT TË TARIFAVE**

Neni 1
Objekti

Ky udhëzues është miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator dhe shërben për të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen nga operatorët për organizimin e seancës dëgjimore me publikun si pjesë e dokumentacionit të procesit për aplikim për ndryshim të tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime. Hartimi i këtij udhëzuesi është bazuar në dispozitat ligjore të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, neni 6, “Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik”.



Neni 2

Fusha e zbatimit

Udhëzuesi është miratuar nga Komisioni me vendimin nr. 37, më datë 6.9.2017, në bazë të ligjit nr. 8102, të ndryshuar, neni 14, germa “e” dhe është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjithë operatorët ujësjellës-kanalizime.

Neni 3

Përkufizime

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe të përpunimit të ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 8102 (i ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr. 8102 (i ndryshuar).

“Konsumatorë” janë të gjithë kategoritë e përfituesve familjarë, publikë dhe privatë (të tanishëm dhe në të ardhmen) të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve.

“Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët të konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

“Shoqëria UK” ose “operator” është subjekti i licencuar nga ERRU që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë.

Neni 4

Qëllimi i seancës dëgjimore

1. Zhvillimi i seancave dëgjimore ka për qëllim sqarimin dhe përfshirjen e publikut në procesin e propozimit të tarifave të reja, rritjen e transparencës, besimit dhe bashkëpunimit të publikut me shoqëritë UK, si element i domosdoshëm i këtyre të fundit në përmbushje të misionit të UK-së në shërbim të publikut.

2. Këto seanca kanë për qëllim, gjithashtu, ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me detyrimin dhe problematikën që hasin shoqëritë për të plotësuar standardet e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, njohjen me objektivat e shoqërisë

për të ardhmen, si edhe kërkesat dhe detyrimet që duhet të përmbushin konsumatorët (publiku) ndaj shoqërisë UK.

Neni 5

Urdhri për zhvillimin e seancës dëgjimore

1. Një seancë dëgjimore zhvillohet mbështetur në urdhrin e administratorit të operatorit.

2. Urdhri sipas pikës 1 të këtij neni përcakton:

a) autoritetin dhe juridiksionin nën të cilin mbahet seanca e dëgjimit;

b) personin drejtues, si rregull është personi përgjegjës për çështjet ekonomike;

c) personat e tjerë të ngarkuar për mbarëvajtjen e seancës dëgjimore;

d) datën, orën dhe vendin e seancës dëgjimore;

e) çdo çështje tjetër të përshtatshme.

Neni 6

Organizimi i seancës dëgjimore

1. Operatorët UK duhet të organizojnë seancë dëgjimore me publikun përpara paraqitjes së propozimit për ndryshim tarife tek ERRU-ja.

2. Operatorët që në zonën e tyre të shërbimit mbulojnë më shumë se një bashki, duhet të organizojnë seancë dëgjimore me publikun të veçantë për secilën bashki të zonës së shërbimit.

3. Preferohet që seanca dëgjimore të zhvillohet të paktën 30 ditë kalendarike përpara dorëzimit të aplikimit për ndryshim të tarifave pranë ERRU-së.

Neni 7

Relacioni për justifikimin e tarifave të propozuara

1. Personi drejtues përgatit një relacion që justifikon propozimin për tarifa të reja që duhet paraqitur gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

2. Relacioni duhet të përmbajë:

a) Përshkrim i shkurtër i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, duke dhënë treguesit kryesorë të performancës, përkatësisht:

- kohëzgjatja e furnizimit me ujë, orë/ditë;

- uji pa të ardhura (humbje administrative e fizike), në %;

- norma e arkëtimit, në %;

- mbulimi i kostove direkte të O&M-së, në %;

- mbulimi i kostove totale, në %.

b) Objektivat e shoqërisë për përmirësimin e treguesve kryesorë të performancës, përkatësisht:



- kohëzgjatja e furnizimit me ujë, orë/ditë;
- uji pa të ardhura (humbje administrative e fizike), në %;
- norma e arkëtimit, në %;
- mbulimi i kostove direkte të O&M, në %;
- mbulimi i kostove totale, në %.

c) Planet e veprimit që ka shoqëria për realizimin e objektivave të mësipërm, kryesisht:

- programi i eliminimit të lidhjeve ilegale (task force);
- programi i rritjes së normës së arkëtimit (task force);
- programi i investimeve (ujëmatës, tubacione, pompa, rezervuare etj.).

3. Relacioni duhet të jetë i publikuar në faqen *web* të shoqërisë UK.

4. Për publikun që nuk ka akses apo mundësi përdorimi të internetit, shoqëritë duhet të ofrojnë kopje të thjeshtuara të printuara të relacionit pranë njësive të komunikimit me klientët.

Neni 8 Njoftimet

1. Operatori njofton publikun për zhvillimin e seancës dëgjimore të paktën një javë përpara mbajtjes së saj nëpërmjet njoftimeve të shpallura:

- në pikat e kujdesit të klientit dhe në të gjitha pikat e tjera të arkëtimit;
- në ambientet e jashtme të njësisë vendore ku ofron shërbime operatori;
- në faqen *web* të UK-së dhe të njësisë vendore ku ofron shërbime operatori;
- në mediat vizive dhe të shkruara kombëtare dhe lokale, si dhe
- njoftimit zyrtar të secilës nga palët që ka shprehur interes për procesin, njësinë/njësitë vendore, përfaqësues të shoqatave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe ERRU-së, jo më vonë se një javë nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës.

2. Njoftimi përmban informacion mbi datën, orën, vendin, qëllimin e zhvillimit të seancës dëgjimore, si dhe linkun në *web* të relacionit të përgatitur në justifikim të tarifave të reja të propozuara.

Neni 9

Procedurat e zhvillimit të seancave dëgjimore

1. Seanca dëgjimore është e hapur për të gjithë banorët e njësisë vendore ku ofron shërbim operatori. Në të mund të marrin pjesë qytetarë të interesuar, përfaqësues të organizatave të mbrojtjes

së konsumatorit apo të shoqërisë civile në përgjithësi, medias, universitetit, strukturave komunitare apo komisioneve këshillimore qytetare (aty ku janë ngritur) etj.

2. Gjatë seancës dëgjimore duhet të jenë të pranishëm administratori i operatorit, përfaqësues të njësive vendore ku ofron shërbimin operatori në fjalë, përfaqësues të ERRU-së, si dhe të të tria kategorive të konsumatorëve (familjarë, privat dhe institucioneve), si edhe persona të tjerë sipas gjykimit të operatorit.

3. Drejtuesit e seancës në konsultim edhe me përfaqësuesit pjesëmarrës të ERRU-së në seancën dëgjimore mund të vendosin për shtyrjen e seancës dëgjimore për një datë tjetër në përputhje me nenin 8, nëse e konsiderojnë të pamjaftueshëm numrin e pjesëmarrësve për zhvillimin e seancës dëgjimore me publikun.

4. Personi drejtues në fillim të seancës dëgjimore duhet t'u shpjegojë të gjitha palëve procedurën dhe rregullat e tjera të zhvillimit të seancës dëgjimore, si dhe çështjet që do të trajtohen gjatë zhvillimit të saj.

5. Prezantimi i relacionit të propozimeve për tarifa të reja bëhet nga personi drejtues i seancës vetëm ose së bashku me stafin kyç menaxhues të shoqërisë UK.

6. Seanca dëgjimore regjistrohet në mënyrë audio ose audiovizive dhe kjo gjë u bëhet e ditur palëve në fillim të seancës.

Neni 10

Rregulla të zhvillimit të seancës dëgjimore

1. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore duhet të ruhet etika e komunikimit.

2. Personi drejtues i seancës dëgjimore do të sigurojë të drejtën e fjalës për secilën nga palët prezente në seancë që e kërkon një gjë të tillë.

3. Çdo person që merr pjesë ka të drejtë të dëgjojë, të mbajë shënime e të bëjë pyetje, sipas radhës së caktuar nga personi drejtues i seancës.

4. Ndalohet ndërprerja e fjalës së folësit dhe përdorimi i celularëve gjatë diskutimeve.

5. Nëse ndonjë nga personat pjesëmarrës konsiderohet se prish qetësinë dhe mbarëvajtjen e seancës dëgjimore, me urdhër të personit drejtues vendoset largimi i tij nga seanca.

6. Prezantimi i relacionit të propozimit për tarifa të reja bëhet në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, në veçanti përshkruhet



gjendja e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, objektivat e shoqërisë UK për vitet e ardhshme, si dhe nevoja për rritjen e tarifave të këtyre shërbimeve.

7. Më tej, personi drejtues i seancës dëgjimore, fton palët të shprehin komentet dhe pyetjet e ndryshme lidhur me aplikimin.

8. Staf i menaxhues i shoqërisë pjesëmarrës në seancën dëgjimore duhet të ketë parasysh që pyetjet dhe vërejtjet që vijnë nga publiku, shpesh janë të formuluar në mënyra dhe forma që mund të jenë jashtë kontekstit dhe termave që përdoren në menaxhimin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve. Në këtë kuadër, për të shmangur konfliktualitetin dhe debatet jokonstruktive, duhet bërë kujdes që sqarimi për qytetarët të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm dhe brenda normave të etikës dhe profesionalizmit.

9. Palët gjatë seancës dëgjimore mund të paraqesin edhe komente me shkrim të cilat administrohen nga operatori. Këto komente diskutohen gjatë seancës dëgjimore.

10. Në përfundim të dëgjimit të të gjitha palëve dhe dhënies së përgjigjeve, personi drejtues deklaron mbylljen e seancës.

11. Nëse seanca kërkon një kohë më të gjatë nga ajo e planifikuar, personi drejtues në këshillim edhe me palët prezente, mund të vendosë vazhdimin e seancës në një ditë tjetër.

Neni 11

Kërkesa ndaj stafit pjesëmarrës në seancën dëgjimore

1. Staf i menaxhues i shoqërisë pjesëmarrëse në seancën dëgjimore duhet të ketë informacionin e duhur në lidhje me cilësinë e shërbimeve në të gjithë rrjetin shpërndarës të ujësjellësit dhe të kanalizimeve. Në veçanti, për rrjetin shpërndarës të furnizimit me ujë, stafi duhet të zotërojë njohuritë dhe informacionet e duhura, mbi:

a) presionin dhe kohëzgjatjen e furnizimit me ujë në të gjitha zonat dhe arsyet kur këto zona nuk mbulohen me presionin e duhur;

b) gjendjen e asetëve në lidhje me vjetërsinë, nëndimensionimin e tyre etj.;

c) arsyet e vlerës së ulët të normës së arkëtimit, nëse është e tillë, si dhe planet e veprimit të shoqërisë për rritjen e saj;

d) nevojat për investime, vlerat e tyre, prioritetet, si dhe mundësinë apo pamundësinë e sigurimit të këtyre fondeve;

e) vlerën e ujit pa të ardhura dhe rrugët e planet e veprimit për reduktimin e tij me anë të investimeve fizike, programit për eliminimin e lidhjeve ilegale, *by-pass*, shpërdorimeve etj.

Neni 12

Transkriptimet

1. Çdo deklaratë e bërë gjatë seancës dëgjimore transkriptohet (zbardhet) në një raport të saktë, pa hequr asgjë, përveç kur personi drejtues urdhëron me shkrim heqjen nga regjistrimet të deklaratave fyese.

2. Pas mbylljes së regjistrimit, ndryshimet në transkriptim nuk lejohen, përveç rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Çdo korrigjim në transkriptimin e një seance dëgjimi mund të bëhet, vetëm nëse personi drejtues vendos se korrigjimi përputhet me regjistrimin audio ose audioviziv në seancën dëgjimore.

Neni 13

Dokumentacioni

1. I gjithë dokumentacioni i seancës dëgjimore, si: urdhri për organizimin e seancës, informacioni i paraqitur gjatë seancës, regjistrimi audio ose audioviziv, procesverbali, komentet me shkrim etj., administrohen në dosjen e seancës dëgjimore.

2. Dosja ruhet sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë dhe është e hapur për inspektim publik.

Neni 14

Raportimi

1. Personi drejtues, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i seancës dëgjimore përgatit një raport me shkrim lidhur me komentet e marra gjatë seancës, konkluzionet e seancës, rekomandimet e mundshme etj. dhe ia paraqet administratorit të operatorit.

2. Një kopje e këtij raporti i dërgohet ERRU-së bashku me gjithë dokumentacionin për aplikim për ndryshimin e tarifave.

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 647, datë 6.7.2017, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Spiro Zoga, i biri i Todit dhe i Agathullës, i datëlindjes 11.12.1967, lindur dhe banues në Kuçovë, si dhe caktimin e shtetasit Artan Zoga, si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij.

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2017-3944) 1292, datë 26.7.2017, vendosi shpalljen të vdekur të shtetases Erinda Vladi, e bija e Hazizit dhe e Zahides, e datëlindjes 15.11.1990, në datën 12.9.1991.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 140 lekë